

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-106/12

**Prishtinë
12 prill 2013**

Në çështjen juridike të:

D.R.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

E. D.

Pala përgjegjëse në kërkesë/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/145/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 22487), e datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 12 prill 2012, morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. R. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/145/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 22487), e datës 29 shkurt 2012.
- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/145/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 22487).
- 3- Shpenzimet e procedurës në shumën prej € 30 (tridhjetë) do të bartën nga pala ankuese dhe duhet të paguhen brenda afatit prej 45 (dyzetë e pesë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 15 mars 2007 D. R. (Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencionit Kosovar të Pronës (AKP) duke kërkuar kompensimin e pronës të përshkruar si banesë prej 32 m², në ngastrën 615, Vitomiricë, Pejë. Ai ka pretenduar se e ka blerë banesën prej komunës në vitin 1993, përveç banesës ai kishte ndërtuar një shtëpi përafërsisht prej 200 m². Ai u largua nga Kosova në qershor 1999. Prona e tij është shkatërruar nga ana e E.D. palës përgjegjëse në kërkesë dhe se tani, paraqitësi i kërkesës dëshiron që kjo të iu kompensohet.

Në mbështetje të kërkesë së tij, z. R. paraqiti kontratën për shfrytëzimin e banesës së datës 1 shtator 1982 si dhe kontratën për shitë-blerjen e banesës në fjalë, të datës 30 shtator 1993.

Paraqitësi i kërkesës e paraqiti E. D. si posedues të pronës.

AKP-ja me 31 mars 2011 e bërë njoftimin duke vendosur afishen në murin e një objekti të ndërtuar në këtë ngastër. Pala përgjegjëse në kërkesë, E. D., e konfirmoi se shtëpia-banesa në atë ngastër në vitin 1999 ishte shkatërruar dhe ai pretendoi se toka i takonte Komunës. Kjo e fundit në vitin 2001 i dha atij lejen për të ndërtuar objektin rreth 160 m². Ai paraqiti fletën poseduese e cila e tregon Komunën si pronare të ngastrës.

Është e jo kontestuese se paraqitësi i kërkesës e ka blerë banesën prej 32 m² në ngastrën e lartcekur dhe se këtë banesë e ka “ngritur” në shtëpi prej 200 m², e cila eventualisht ishte shkatërruar në konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999. Është vërtetuar se ngastra në të cilën ishte ndërtuar banesa i takon Komunës. Është e jo kontestuese se pala përgjegjëse në kërkesë pas luftës në vitin 2001 e ka ngritur ndërtesën e cila përdoret si dyqan për ndreqjen e makinave.

Me vendimin të përbashkët KPCC/D/145/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 22487) është pranuar se kërkesa nuk është brenda mandatit të Komisionit ashtu siç përcaktohet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-07. Komisioni ka theksuar se kërkesa e vetme e paraqitësit të kërkesës ka të bëjë me kompensimin e pronës së shkatërruar dhe kërkesat e tilla nuk janë brenda mandatit të Komisionit, prandaj KKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën.

Pas vendimit të përbashkët, me 6 prill 2012, KKPK-ja ka lëshuar vendimin individual për hedhjen poshtë të kërkesës.

Paraqitësi i kërkesës u njoftua për vendimin me 02 korrik 2012.

Me 20 korrik 2012 ai parashtroi ankesë pranë Gjykatës Supreme kundër vendimit të lartcekur. Në ankesë ai pohon se ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së tij pronës mbi një banesë në Vitomiricë, Pejë, në sipërfaqe prej “36.22 m², mirëpo në sipërfaqe reale prej 200 m², duke përfshirë 20 m² bodrum si dhe 700 m² oborr. Ai pretendon se KKPK-ja ka theksuar gabimisht se ai ka kërkuar vetëm kompozimin. Ai pohon se ka kërkuar prej Komisionit që ta konfirmoj të drejtën e tij të pronës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Është paraqitur brenda 30 ditëve ashtu siç përcaktohet nga nenin 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-07.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është drejtë, rasti nuk është brenda kompetencave të KPPK-së.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon të drejtën në pronë, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojnë ato të drejta pronësore sipas rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. KPPK-ja nuk e ka mandatin që të lëshoj vendimi në lidhje me kërkesat për kompensim në lidhje me pronën e paluajtshme private të shkatërruar. **Vetë Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 nuk parasheh mekanizma kompensimi për pronën e shkatërruar.**

Përderisa kërkesa është jashtë kompetencave të KKKPK-së, Komisioni nuk ka nevojë që të vendos mbi pronësinë e ankuesit.

Në ankesë është theksuar se paraqitësi i kërkesës nuk ka kërkuar kompensim por ri-posedim e që nuk është në përputhje me kërkesën e paraqitur pranë AKP-së. Shprehimisht ajo thekson se kërkesa është për kompensim. Kërkesa më pas as nuk është ndryshuar dhe as edituar në çfarëdo mënyre, prandaj KPPK-ja është dashtë të vendos brenda kuadrit të kërkesës ashtu siç është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Në kuadër të kërkesës nuk është përfshirë kërkesa për vërtetimin e pronës dhe/ose ri-posedim.

Herën e parë përmes ankesës, ankuesi ka theksuar se kërkesa e tij nuk ishte për kompensim por për pronësi, megjithatë, kjo nuk bazohet në përmbajtjen e dosjes së shkallës së parë, nuk bazohet as në kërkesë e as në ndonjë dokument ose deklaratë brenda saj. Prandaj, pohimet në ankesë duhet të trajtohen vetëm si argumente mbrojtëse. Gjykata, as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë, nuk mund të këshilloj *plus petitum*, Gjykata gjykon vetëm brenda kuadrit të kërkesës së paraqitur-argumenti sipas nenit 2.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, që aplikohet *mutatis mutandis* sipas nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-07.

Shpenzimet e procedurës:

Pala ankuese ka kërkuar që të lirohet nga obligimit për të paguar taksen sipas nenit 468 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Gjykata përmes një urdhri ka kërkuar prej tij që të parashtroj dëshmi nëse a është i papunë dhe/ose përfitues i asistencës sociale ose çfarëdo dëshmie tjetër që e mbështesin pretendimin e tij se pagimi i taksës për procedurën e ankesës do ta rrezikonte ekzistencën e tij apo të familjes së tij. Pala ankuese nuk ka paraqitur ndonjë prej këtyre, ai ka theksuar se ai nuk është i pa punë mirëpo të ardhurat e tij nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e familjes së tij. Megjithatë, ai nuk i ka siguruar gjykatës ndonjë të dhënë për të ardhurat e tij në bazë të të cilave Gjykata do ta vlerësonte nëse pretendimi i palës ankuese është i vërtet.

Po ashtu pala ankuese ka pohuar se *“praktika e pagimit të taksave është në kundërshtim me nenin 13.2 të Parimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Rikthimin e Pronës Banesore dhe Pronës për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur (Parimet e Pinheiro), që parasheh se shtetet duhet të i sigurojnë se të gjitha aspektet e procesit të kërkesave për rikthim, duke përfshirë procedurën e ankesave të jenë në kohë, të qasshme dhe pa pagesë. Neni 29.2 i Parimeve udhëzuese të KB mbi Zhvendosjen e brendshme nuk është respektuar, që i obligon autoritetet kompetente që të i asistojnë personat e zhvendosur që ta kthejnë pronën. Diskriminimi i tërthorë ndaj personave të zhvendosur kryhet me mbledhjen e taksave sepse gjendja e vështirë financiare, e shkaktuar nga zhvendosja nuk është marr parasysh”*.

Duhet të qartësohet se zbatimi i Parimeve të Pinehiros si instrument i “ligjit të butë” është çështje e politikave qeveritare, jo për zbatim të drejtpërdrejt nga ana e Gjykatës. Instrumentet e “ligjit të butë”, sikurse ai në fjalë nuk kanë vlerë ligjore e as fuqi detyruese dhe ato as që mundën dhe nuk duhet të sigurojnë mbrojtje të plotë gjyqësore. Ato mund të përdoren si mjete përgatitorë për krijimin dhe themelimin e akteve detyruese legislative. “ *Këto parime janë hartuara për të u siguruar udhëzime Shteteve, Agjencive të KB-së si dhe komunitetit të gjerë ndërkombëtar se si të adresohen më së miri çështjet e ndërlikuara ligjore dhe teknike që kanë të bëjnë me banimin, tokën dhe riktëhimin e pronës*”, ashtu siç është formuluar në hyrje të broshurës “ Parimet e Pinheiros”, të lëshuar nga Qendra për të Drejtat e Banimit dhe Dëbimi. Ashtu siç u theksua Parimet nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata. Gjykata i zbaton Ligjet kombëtare dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare në të cilat Shteti në fjalë është palë.

Prandaj, regjimi i taksave të vendosura të gjykatës zbatohet në këtë rast:

Në përputhje me Shtojcën III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2): nuk duhet të zbatohet ngase kjo taksë vërtetohet në bazë të vlerës së pronës ndërsa prona në fjalë është shkatërruar .

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga Pala ankuese e cila ka paraqitur kërkesë të papranueshme e cila është bërë arsye për procedurën e ankesave. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos që në rastin konkret afati është prej 90 ditësh. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë do të kryhet përmbarimi i detyrueshëm.

Këshillë juridike:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it